

**DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS**  
**ZYRA E TE DREJTAVE DHE PERGJEGJESIVE TE NXENESIT**  
**440 N. Broad Street, 2<sup>nd</sup> Floor**  
**Philadelphia, PA 19130**  
**Rachel Holzman, Esq., Deputy Chief**  
**Phone: 215-400-4830 / Fax: 215-400-4831**

**Udhëzues i Prindit për Procesin Disiplinor të Nxënësit**

- I. Çfarë është e pritëshme në rast se fëmija juaj është përfshirë në një incident, i cili sipas Kodit të Sjelljes së Nxënësit, kërkon një proces Dëgjimor Disiplinor.
- A. Të informoheni prej shkollës për incidentin ku është përfshirë fëmija juaj, kur është e mundëshme, në të njëjtën ditë kur ka ndodhur incidenti.
- B. Të merrni një Njoftim për Pezullim ku detajohen Sjelljet e Papërshtatëshme, numri i ditëve që pezullohet dhe data e ora, kur do të mbahet një takim i përbashkët me prindin.
- C. Të marrësh pjesë në një takim me prindin, ku do të shtjellohen si më poshtë:
1. Ju do të informoheni në detaje për incidentin e ndodhur, përfshirjen e fëmijës tuaj, arsyet pse shkolla kërkon një seancë dëgjimore dhe çfarë pritet në të ardhmen nga procesi.
  2. Ju do të keni mundësitë të shikoni të gjitha faktet që implikojnë fëmijën tuaj në incident. Faktet mund të përfshijnë fotografi, video, deklarata, raporte etj. Informacionet identifikuese të nxënësve nuk do të paraqiten në faktet.
  3. Juve do t'ju ofrohet një kopje e TE GJITHE dokumentacionit të shkruar (gjithë paketa EH-21 ), që është dërguar në Zyrën e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Nxënësve, bashkë me kërkesën e shkollës për një proces disiplinor Dëgjimor. Dokumentacioni nuk do të përfshijë materialin mjekësor, që lidhet me personat e tjerë.
  4. Ju do të informoheni për pasojat e rekomanduara nga shkolla. Shkolla mund të rekomandojë që fëmija juaj të lejohet të qëndrojë në këtë shkollë, me një kontratë sjelljeje, ose që ai të transferohet në një shkollë tjetër publike, ose në një shkollë disiplinore.
  5. Juve do t'ju ofrohet referencë për Programin për Asistencën e Nxënësit (SAP). Kjo i mundëson fëmijës tuaj burime dhe vlerësim të sjelljes të tij/saj.  
**Pranimi i këtij shërbimi, nuk është pranim i fajit nga ana e fëmijës tuaj.**
- D. Kthimi në shkollë pas përfundimit të afatit të shënuar në Njoftimin për Pezullim. Pezullimi nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë rradhazi.

Shënim: Në rast se fëmija juaj është përfshirë në një incident, ku viktimja është identifikuar, klasa, ose programi i fëmijës tuaj do të ndryshojnë, në mënyrë të tillë që të mos jenë në të njëjtin vend me viktimën

- II. Pasi kërkesa për seancë dëgjimore është marrë prej Zyrës së të Drejtave dhe Përgjegjësive të Nxënësve dhe është caktuar data e seancës Dëgjimore, në vazhdim do të kemi:
- A. Ju do të merrni në gjuhën tuaj një Njoftim për Seancë Dëgjimore, ku do të shënohen data, ora dhe vendi i seancës
    - 1. Në rastet kur ju dhe/ose fëmija juaj nuk keni mundësi të merrni pjesë në këtë datë, duhet që menjëherë të njoftoni Zyrën e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Nxënësve , në numrin 215-400-4830.
  - B. Ju dhe fëmija juaj keni mundësinë që në seancën dëgjimore:
    - 1. Të sillni dëshmitarët tuaj.
    - 2. Të paraqitni fakte dhe raporte.
    - 3. Të sillni familjarë, përfaqësues, avokatë, etj.
  - C. Oficeri i seancës dëgjimore do të drejtojë pyetje për ju dhe fëmijën tuaj, për çdonjërin që ju keni sjellë, si edhe për përfaqësuesit e shkollës, në lidhje me incidentin dhe fëmijën tuaj.
  - D. Oficeri i seancës dëgjimore do të vendosë nëse fëmija juaj ka kryer shkeljet e kodit në incidentin që po trajtohet dhe pasojat përkatëse.
  - E. Në përfundim të seancës dëgjimore,ose brenda 48 orëve të ardhëshme, do të jetë në dispozicionin tuaj, një përmbledhje e saj, ku përfshihet edhe vendimi i oficerit të seancës dëgjimore. do të jetë në dispozicionin tuaj,